



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Pejë 04.06.2025

Në mbështetje të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 dhe, autoriteti kontraktues Komuna e Pejës (ne vazhdim AK KK PEJE . apo Autoriteti Kontraktues) ka shqyrtuar Kërkesën për Rishqyrtim të operatorit ekonomik "**CONEX L.L.C.**" pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i rrugëve në fshatrat e Lugut të Baranit, Lugut Leshanit Trestenikut dhe Radacit –Komuna Pejë LOT 1 Asfaltimi i rrugëve Radavc , Novoselle ,Jabllanice e Madhe, Vitomerice ,Katund i ri LOT 2 Asfaltimi i rrugëve Treboviq ,Nakull, Bllagaj LOT 3 Asfaltimi i rrugëve Nabergjan Trestenik Ruhot Lutogllave, Llabjan, Qyshk, Loxhe, Leshan,Lubeniq,Vranoc,Raushiq,Broliq dhe Graboc LOT 4 Asfaltimi i rrugës tek Qerdhja e Qytetit “ Pellumbat e paqes , nrprok te brendeshem. 635-25-022-511// 635-25-109-5-1-1 dhe ne lidhje me kërkesën, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Cilësohet e **refuzuar** kërkesat për ri-shqyrtim nga operatori ekonomik "**CONEX L.L.C.**" pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit : Ndërtimi i rrugëve në fshatrat e Lugut të Baranit, Lugut Leshanit Trestenikut dhe Radacit –Komuna Pejë

SQARIM

Me datën **04.06.2025**, operatoi ekonomik "**CONEX L.L.C.**" ka parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues (**KOMUNA E PEJES**) kërkesat për rishqyrtim me pretendimet si me poshtë:

Në vijim të procedurës së prokurimit të iniciuar me datën 13.05.2025, dokumentacionin përkatës është dërguar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për shqyrtim dhe miratim. Pas analizimit të dosjes së tenderit, kemi vërejtur se kontrata është ndarë në katër (4) Lote, Në përputhje me nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), që përcakton se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, ndarja e kontratës në Lote ka për qëllim, Sigurimin e konkurrencës së ndershme: Duke mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të ndryshëm, përfshirë ata me kapacitete të ndryshme. Përmirësimin e efikasitetit dhe ekonomikitetit, Duke lejuar specializimin dhe optimizimin e burimeve për secilin Lotë, Respektimin e parimeve të barazisë dhe jo-diskriminimit, Duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë.

Gjithashtu, sipas nenit 6 të LPP-së, është e domosdoshme që autoritetet kontraktuese të sigurojnë ekonomikitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike. Ndarja e kontratës në Lote kontribuon në arritjen e këtyre objektivave.

Në përputhje me nenin 7 të LPP-së, autoritetet kontraktuese janë të detyruara të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe të sigurojnë konkurrencë të ndershme. Ndarja e kontratës në Lote mund të rrisë mundësitë për pjesëmarrje dhe të sigurojë një proces prokurimi më të drejtë.

Për më tepër, sipas nenit 28 të LPP-së, autoriteti kontraktues është i detyruar të përpilojë specifikimet teknike në mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe tenderuesit.

Mirëpo gjatë krijimit të dosjes së tenderit nga Autoriteti Kontraktues vet AK ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe Rregulloren e Prokurimit Publik Nr.001/2024, pasi që sipas nenit 44 të LPP-së paragrafi 2.1 thekson se: Gjatë një procedure prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: 2.1. kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë; mirëpo nga ky rast AK vendos vetem 28 ditë për dorëzimin e këtyre ofertave gjë që e bën të pamundur plotësimin verifikimin e kriterëve të kërkuar për Operatorin Ekonomik, pasi që ditët e shkurtuara nuk lejojnë efikasitet dhe siguri në pregaditjen e dokumentacionit.

Me datën 01.06.2025 përmes platformës e-prokurimi tek dokumentacioni sqarimi DT-së konform rregullores dhe LPP, OE-“Conex” L.L.C paraqet kërkesë për sqarim DT-së lidhur me kriteret dhe specifikat e kërkuara nga AK, për lotet 1,2,3,4, dhe parashtron 10 pyetje nga secili pozicion ku ka dilema dhe kërkesa të formuara në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së, nga 10 pyetjet e dërguara, AK me datën 01.06.2025 përgjigjet teoritikisht vetem në 2 pyetje dhe përmbyll procedurën me një sqarim të pa detajuar për secilen pyetje nga 10. Pse ju si AK dhe Njesia Kërkuese lidhur me pyetjet për sqarim nuk theksuar rolin dhe formatet e nevojshme. Konform nenit 24 të RrPP Nr.001/2024 ky nen thekson: AK do të shqyrtoj menjëherë kërkesën sipas paragrafit 24.3 të kësaj rregullore dhe do të konstatoj nëse informata shtesë ose sqarimi i kërkuar është i nevojshëm apo jo dhe se

a. Nëse jo, AK do të informojë menjëherë përmes platformës OE në fjalë për mohim.

b. Nëse po, AK do të ofrojë informatat shtesë menjëherë përmes platformës, por nuk do të bëjë të ditur burimin e kërkesës së tillë, me qenë se ka bërë korrigjimin konform B54 dhe korrigjimin e DT-së atehere pyetjet bien të “pranuara-pohuara” me qenë se janë pranuar si bazë pyetjet dhe si të tilla kanë koncept rreth DT-së, AK është dashur që për secilen pyetje të jap përgjigjen konform neni 24 të RrPP Nr.001/2024, apo për secilen pyetje të japë mohim sipas paragrafi 24.4 pikës a), Ju si AK keni theksuar se gjitha kriteret janë të formuluara konform nenit 58,28 paragrafi 4 dhe 6, e në harmoni të plotë me ligjin prokurimit public dhe me rregulloren e saj, është e vertetë që kriteret dhe specifikat krijohen konform ketyre neneve pasi që ligji prokurimit nuk parasheh ndonjë rregullore tjetër, mirëpo janë OE, dhe konkurenca që verifikojn dosjet e tenderit, paraqesin sqarim, kërkesa për rishqyrtim e pse jo edhe ankesa në OSHP lidhur me krijimin e kriterëve diskriminuese/favorizuese që eliminoj OE në fazën e para tenderimit, andaj nga mos sqarimi i pyetje nga AK për 10 pyetjet e parashtruara, shihet qartë një gjendje për kritere diskriminuese dhe të pa bazë që ndërliken me natyrën e projektit, ne drejtohem ju si AK dhe me argumente se kriteret e specifikuara në DT që ju kërkonin janë në kundërshtim me LPP dhe Rrpp, e që vlenë të korrigjohen të shtyhet afati dhe të ofrohet një tenderim konform neni 1,6 dhe 7.

Kriteri 1: Nje(1) inxhinier master i shkencave teknike për mbrojtjen e ambientit i licencuar me VNM nga Ministria e Ambientit me përvje pune min 7 vite.

Argumenti lidhur me kriterin 1: Në përputhje me kërkesat e tenderit dhe karakteristikat e projektit, asnjë nga aktivitetet e planifikuara në të gjitha lotet e projektit nuk parashikon ndotje të ajrit, shkatërrim të ekosistemeve, ndryshime të shpejta të peizazhit, ose ndotje të ujërave apo të tokës që do të kërkonin një inxhinier të mbrojtjes së ambientit, duke analizuar përshkrimin e projektit,rezulton se nuk ka punë që përfshijnë ndonjë të mjedisit që kërkon raport të VNM-së sipas Ligjit nr.03/L-015, kjo kërkesë është joproporcionale dhe nuk ka lidhje me objektin e kontratës, e cila bie ndesh me nenin 59 të LPP-së si dhe parimet e konkurrencës sipas neni 7 të LPP-së.,shih ligjin për Vlerësimin Strategjik të ndikimit në Mjedis (Ligji Nr.03/L-015) ku thekson se Inxhiniera e VNM kërkonin zakonisht në projekte të mëdha si hidrocentrale,apo në zona të mbrojtura, me qenë se këtu kemi të bëjmë me rrugica atehere kërkesa e këtij inxhinieri bie ndesh me LPP dhe RrPP.

Për shembull, në LOTIN 2, të cilat lidhen me aktivitete që nuk përfshijnë ndërhyrje direkte të ndërtimit të infrastrukturës mjedisore, kërkesa për angazhimin e një inxhinieri të mbrojtjes së ambientit është e tepërt dhe nuk ka një bazë të qartë për ta justifikuar e ku poashtu njejtin funksion kanë edhe Lotet tjera si LOTI 1,3,4, Duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve të planifikuara në këtë projekt, është më e përshtatshme të angazhohet një inxhinier ndërtimi që ka ekspertizë në fushën e ndërtimit të rrugëve dhe infrastrukturës. Ky profesionist do të jetë në gjendje të sigurojë që punimet të realizohen në përputhje me standardet e kërkuara dhe të monitorojë cilësinë e materialeve dhe punimeve konform standardeve,Në përfundim, kërkojmë nga AK-Komuna e Pejës të largoj kërkesën për angazhimin e një inxhinieri të mbrojtjes së ambientit në LOT 2 dhe të konsiderojë angazhimin e një inxhinieri ndërtimi që është më i përshtatshëm për natyrën e aktiviteteve të planifikuara. Ky hap do të sigurojë që projektet të realizohen në përputhje me standardet e kërkuara dhe të shmangin angazhimin e profesionistëve të panevojshëm që është në kundërshtim me neni 28 të LPP-së dhe Rrpp

Nr.001/2024 neni 19 paragrafi 19.4, duke optimizuar burimet dhe duke siguruar një realizim më efikas të projektit.

Kriteri 2: Nje(1) inxhinier i diplomuar apo master per menaxhim e emerxhencave minimum 3 vite pervoje pune pas diplomimit, i certifikuar per menagjim e shendetit dhe sigurs ne pune.

Argumenti lidhur me kriterin 2: Gjatë sqarimi DT-së nuk kemi marrë përgjigje lidhur me këta inxhinier, andaj vlenë të cekët se kemi 4 LOTE, dhe se AK ka parashikuar vetem rrezikun për Lotin 2 për këtë inxhinier, ndërsa për loti 1,3,4, nuk ka kërkuar një inxhinier të tillë, menaxhimi emerxhencave zakonisht nga inxhinier të tillë bëhet në ambiente të brendshme si objekte, dhe jo për teren të hapura infrastrukturës rrugore, duke ditur se stafi i puntorëve dhe menaxhmentit tani kryen certifikime për siguri dhe shëndet në punë ku trajnohen për të gjitha pikat, andaj inxhinieri i tillë vetem që është në kundërshtim me neni 28 të LPP-së dhe Rrpp Nr.001/2024 neni 19 paragrafi 19.4, që paraqet angazhimin e profesionistëve të panevojshëm, kërkojm nga AK që të largohet apo zevendesohet me inxhinier të ndërtimtarisë konstruktiv 5 vite përvoj pune i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. Kriteri 3: Për (LOT -3) Operatori duhet të deshmtoj se sistemi menaxhues i ofertuesit permbush kriteret e percaktuara ne fushen e ndertimtaris se pako per keto ISO standard -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë -ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor -ISO 45001 2015 - Certifikata për menaxhimin e shëndetit në punë EN - ISO 39001 2012 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor

Argumenti lidhur me kriterin 3: Gjatë krijimit të specifikave të tenderit dhe paraqitjen e standardeve të mundëshme , AK duhet të paraqesë standarde që përshtaten natyres, andaj me qenë se kemi të bëjm me ndërtim rrugëve infrastructure rrugore, vlenë të ceket pse është e nevojshme që këto standarde të jenë vetem për LOTI 3, e ku edhe LOTI 1,2,4, janë natyres së njejtë, pra cilësi të tregohet vetem për LOTI 3 e për lotet tjera nuk që e nevojshme cilësia, andaj kërkojm nga AK që të largoj ISO për LOTI 3 apo ti vendos për të gjitha lotet 1,2,3 dhe 4, në të kundërtën parasheh favorizim të një kompanie të caktuar.

Kriteri 4: Për (LOT-1) ,Kërkesa 2.1,Një (1) bachelor i diplomuar I ndertimtaris – drejtimi Hidroteknike, minimum 6 vite proveje pune pas diplomimit, i certifikuar per drenazhimte dheut dhe i certifikuar per menaxhim te kantierit.

Argumenti lidhur me kriterin 4:Duke shiquar paramasën-parallogarin e LOTI 1, gjatë analizimit shihet që nuk ka pozicionim të kantierit dhe së nuk ka pozicione të drenazhimit të dheut, kjo parallogari parasheh vetem germim,zhavor,asfaltim, andaj inxh. sipas kërkesë në kundërshtim me neni 28 të LPP-së dhe Rrpp Nr.001/2024 neni 19 paragrafi 19.4, që paraqet angazhimin e profesionistëve të panevojshëm, kërkojm nga AK që të largohet, apo të zevendesohet me inxh.drejtimit hidroteknikes 10 vite përvoj pune, pasi që përbën një pengesë të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik që i plotësojnë kërkesat thelbësore, por jo këtë kusht të panevojshëm.

Kriteri 5: Sipas Anex 7 Lista e Paisjeve LOTI 1- Makineria:

Eskavator me zingjir gome me lopat rafshuese 13 tone,
Pirunera qe vendosen ne eskavator.

Argumenti lidhur me kriterin 5: Në kundërshtim me neni 28 të LPP-së dhe Rrpp Nr.001/2024 neni 19 paragrafi 19.4, që paraqet angazhimin e makinerive të panevojshëm, pasi që Eskavator: zingjir gome me lopat rafshuese 13 tone, parasheh një favorizim dhe nje tonazh fikse 13tona, AK duhet të paraqet makineri me një minimum dhe me nje maksimum andaj tonazhe fikse 13tona parasheh favorizimin e një OE që posedon këtë makineri, dhe se ky lloj eskavatorit është i njejt me Buldozer dhe kryen të njejtin funksion, makinerit me zingjir gome nga ana teknike përdoren në zona urbane brenda qytetit e jo për ndertim rrugëve,andaj kërkojm nga AK që të zevendesoj këtë makineri me Eskavator me zingjir mini 13 tona apo maximum 13 tona, e sa i përket funksionit të lopat rafshuese janë kërkuar tek kjo list edhe Ngarkues minim 22 tone sipas nr rendor 5, që kryen funksionin e njejtë, andaj të korrigojohet kjo makineri korrigjimi të behet të DT dhe përmes B54 të njoftohet OE, Ndërsa pirunera që vendosen në eskavator edhe kjo makineri është e panevojshme pasi që nuk kemi të bëjm me zhgarkim dhe ngarkim të produkteve/mallrave dhe se kërkesa është joproporcionale dhe e paarsyetuar teknikisht edhe përmes sqarimeve të DT-së paraqitur me datën 01.06.2025, andaj paisja sipas listes së ANEKS 1 për LOTI 1, me nr rendor 12 dhe 16 të largohen. Kriteri 6: Sipas Anex 7 Lista e Paisjeve për LOTI 2- Makineria:

Kompresor i ajrit minim 2 tone

Konteiner Min 4 ton

Argumenti lidhur me kriterin 6: Janë në kundërshtim me neni 28 të LPP-së dhe Rrpp Nr.001/2024 neni 19 paragrafi 19.4, që paraqet angazhimin e makinerive të panevojshëm, Kompresor i ajrit minim 2 tone- mund të zevendesohet me Kompresor ajri pasi që kjo pasije parashihet funksioni i saj me shtypje në barë dhe jo me tonaz, specifikimi tonazhes parasheh favorizim, andaj kërkojm të zevendesohet me Kompresor ajri.

Konteiner Min 4 ton- nuk parashihet në paramasën-parallogarin dhe se nuk është e lejuar që kontinieri të vendoset në rrugica, me qenë së AK ka shprehur kriter favorizus dhe diskriminues kërkojm që kontinier të largohet apo të zevendesohet me Konteiner pa tonazh.

Kriteri 7: : Sipas Anex 7 Lista e Paisjeve për LOTI 3-Makineria

Eskavator me rrota gome me lopatë dhe pirunier, min pesha 4-6 ton,

Argumenti lidhur me kriterin 7: Janë në kundërshtim me neni 28 të LPP-së dhe Rrpp Nr.001/2024 neni 19 paragrafi 19.4, që paraqet angazhimin e makinerive të panevojshëm,

Eskavator me rrota gome me lopatë dhe pirunier, min pesha 4-6 ton, asnjë Eskavator nuk e ka mundur që njëkohësisht të mbajë edhe lopatën edhe pirunierin, AK gjatë krijimit të kriterëve të formuloj kërkesa konfor neni Rrpp Nr.001/2024 neni 19 paragrafi 19.4, që të jenë të qarta dhe të kuptueshme, poashtu pozicioni lopatë dhe pirunier vetem sa krijon dilema dhe mund të krijoj një shkelje ligjore që mund të rezultoj në anulimin,dëmshpërblimin lidhur me procedurën atehere kërkojm që të zevendesohet me Eskavator me rrota gome pesha mini 4-8tona, që shpreht aftësin edhe pozicionimin e një paisje konform kriterëve dhe standardeve mbi makinerit.

Lidhur më listën Sipas Anex 7 Lista e Paisjeve për LOTI 1,2 dhe 3, sipas sqarim DT i kemi propozuar AK që për të gjitha lotet të paraqet: Propozim Listen e cila për secilin lot nuk do paraqiste asnjë favorizim dhe as një diskriminim që për secilin lot do të ishte e përshtatshme dhe konform specifikave dhe natyrës të punës, lista parasheh gjitha makineri adekuate që përdoren për shtrimin e rrugëve në infrastrukturë rrugore. Përvec listës AK kemi propozuar që në mënyrë që të mos ketë favorizime dhe diskriminime në krijimin e monopoleve dhe të mos eliminoj Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të paraqitet poashtu

Përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim " OE: "CONEX L.L.C..

Lidhur me kërkesën tuaj për rishqyrtim të dorëzuar në lidhje me aktivitetin e prokurimit të inicuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës, ju njoftojmë se kemi shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet e parashtruara dhe ju ofrojmë sqarimet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje të plotë me dispozitat e **Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës**, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, si dhe në harmoni me **Rregulloren për Prokurimin Publik – Versioni i konsoliduar**, duke respektuar të gjitha parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

1. Për afatet kohore të procedurës së prokurimit

Në lidhje me afatet kohore, sqarojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me **nenin 6 të Rregullores për Prokurimin Publik**, ku përcaktohet qartë se në rastet kur është publikuar një **njoftim paraprak**, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të aplikojë afate të reduktuara për dorëzimin e ofertave.

Konkretisht:

- **Njoftimi Paraprak** është publikuar më datë **14.01.2025**, duke përmbushur obligimin ligjor për informimin paraprak të operatorëve ekonomikë për iniciimin e një procedure të prokurimit me vlerë të madhe.

- **Njoftimi për Kontratë** është publikuar më datë **13.05.2025**, ndërsa **data e hapjes së ofertave** është caktuar për **10.06.2025**, që përbën një afat prej **28 ditësh**, pra përtej minimumit të lejuar prej **24 ditësh**, sipas **nenit 6.5.b të Rregullores për Prokurimin Publik**, i cili autorizon zbritjen e afatit minimal kohor për procedurat me vlerë të madhe nëse është bërë njoftimi paraprak.

Kjo tregon qartë që janë respektuar në përpikëri dispozitat ligjore, dhe se pretendimi për mospërputhje kohore është i **pabazuar në fakte dhe në ligj**.

2. Lidhur me ndryshimin e dokumentacionit të tenderit (Lista e pajisjeve)

Në lidhje me sqarimet dhe komentet e bëra në platformën elektronike për sa i përket pajisjeve të kërkuara, Autoriteti Kontraktues ka vepruar sërish në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, duke realizuar përmirësimet përkatëse:

- Është bërë **korrigjimi i gabimeve në dokumentet e publikuara**, përmes **Formularit standard B54**, që parasheh mënyrën e ndryshimit të dokumentacionit të tenderit, siç kërkohet nga ligji.
- Në dosjen e tenderit është hequr dhe korrigjuar lista e pajisjeve të kërkuara, duke reflektuar korrektësisht kërkesat e njësisë kërkuuese dhe duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

3. Për kriteret profesionale dhe teknike të personelit të kërkuar

Në lidhje me kërkesat për personelin teknik të specializuar, siç janë:

- Inxhinieri Master i Shkencave Teknike për Mbrojtje të Ambientit, i licencuar nga Ministria e Ambientit, dhe
- Inxhinieri për Menaxhim të Emergjencave me përvojë dhe certifikim në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë,

sqarojmë se këto kërkesa janë në **përputhje të plotë me natyrën dhe kompleksitetin e projektit**, i cili ka një **vlerë të parashikuar prej 1,305,397.25 EUR**, çka e kategorizon atë si një **projekt me vlerë të madhe**, që kërkon angazhim të ekspertëve të licencuar dhe me përvojë në fushat përkatëse.

4. Lidhur me ndarjen në lote dhe justifikimin e kërkesave për Lot 3 per certifikata

Për **Lotin 3**, sqarojmë se:

- Ky lot përfshin ndërhyrje infrastrukturore në **13 fshatra të Komunës së Pejës**, përfshirë Nabërgjanin, Trestenikun, Ruhotin, Lutogllavën, Llabjanin, Qyshkun, Loxhën, Leshanin, Lubeniqin, Vranocin, Rashiqin, Broliq dhe Grabocin.
- Çdo fshat ka specifikat dhe kërkesat e veta teknike dhe operacionale, dhe për këtë arsye është e domosdoshme që **Operatorët Ekonomikë të jenë të certifikuar me standarde të larta teknike**, ashtu siç përcaktohet në Dosjen e Tenderit.

Për krahasim, **Lotët 1, 2 dhe 4** përfshijnë ndërhyrje në një numër shumë më të vogël fshatrash (3-4 fshatra për Lot 1 dhe 2; vetëm një rrugë për Lot 4), andaj natyra e punimeve dhe kërkesat teknike janë më të lehta në krahasim me Lotin 3.

Bazuar në të gjitha faktet e mësipërme, si dhe në analizën ligjore të çdo aspekti të përmendur në kërkesën për rishqyrtim, vlerësojmë se:

- Aktiviteti i Prokurimit është zhvilluar në **përputhje të plotë me LPP-në dhe Rregulloren për Prokurim Publik**;
- Janë respektuar afatet, procedurat, dhe format ligjore për njoftim dhe ndryshim dokumentacioni;
- Kërkesat teknike dhe profesionale janë të **justifikuara dhe të ligjshme**, në përputhje me kompleksitetin dhe vlerën e projektit;
- **Pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim janë të pabazuara**

Për rrjedhojë, **hapja e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit do të vazhdojë konform specifikimeve të Dosjes së Tenderit**, pa ndonjë ndryshim.

Me respekt

Menaxher i Prokurimit
MILOT GASHI

